

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies zhvilluan një trajnim dy ditor me temë " Aftësitë Komunikuese dhe Bashkëpunimi për Shërbim Cilësor".

Ky trajnim kishte si qëllim zhvillimin e aftësive të studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive në çdo situatë që lidhet me aktivitetin e tyre profesional. Ky trajnim u fokusua tek gama e aftësive ndërpersonale që kontribuojnë në një komunikim efektiv. Trajnimi inkurajoi pjesëmarrësit të reflektonin mbi cilësinë e komunikimit të tyre, si dhe të marrëdhënieve në punë. Ky trajnim ofroi sugjerime, teknike dhe ide që ndihmuan pjesëmarrësit të zhvillohen dhe të përmirësohen.

Temat që u trajtuan ishin:

- Kuptimi i rëndësisë së Komunikimit.
- Familjarizimi me konceptet, termat bazë të komunikimit dhe mënyrat e duhura të përdorimit të tyre.
- Aftësi për zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme komunikuese në varësi të situatave.
- Aftësi për përgatitjen e prezantimeve verbale.
- Publiciteti dhe komunikimi.
- Koncepti i marrëdhënieve me publikun.
- Roli dhe detyrat e publicitetit.
- Efektet e publicitetit.
- Karakteristikat e komunikimit strategjik.
- Aftësia për të prezantuar çështje në mënyrë efektive përpara audiencave të ndryshme.
- Kuptimi i të komunikuarit efektiv dhe të dëgjuarit efektiv.

Ky trajnim u zhvillua me studentët e ciklit master të çdo fakulteti.



